# DËSHMI ARKIVI

**A-446940**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Daja i deputetes më ka përdhunuar”/ Pas akuzës së 34-vjeçares reagon Zegjine Caushi \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/15/daja-i-deputetes-me-ka-perdhunuar-pas-akuzes-se-34-vjecares-reagon-zegjine-caushi/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 17:57:20 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 17:52:26 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `44f5965f67c4beceb849d6de94d9f960713e1ec6233e3d3e1f67b8c050f96adf` |
| TEKSTI | `563b66ce040362095228627aec98e34f14c364f16d2c3da2bfe9d205e7524c8d` |
| PAMJA | `89ffc48ca7b3f01962edc1d1d0e39b7e87b3b9826024f51f1b5fa4329c38c483` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b817cfce1efa2d20c44a6cc5f745341331e5df23ec9e19bf68987c2a320a8c4f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `80f8ed3d4c77708449a259db492a6c9a12b9addcfc62e639a2bd2cb31edd1709` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b817cfce1efa2d20c44a6cc5f745341331e5df23ec9e19bf68987c2a320a8c4f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Daja i deputetes më ka përdhunuar”/ Pas akuzës së 34-vjeçares reagon Zegjine Caushi

19:52 : 15/09/2026 në **AKTUALITET**, **Lajmet e Dites**, **POLITIKE**



Deputetja e Partisë Socialiste, Zegjine Caushi, ka reaguar pas përfshirjes së dajës së saj, Bledar Bakaj, në ngjarjen e raportuar në fshatin Suk 2, ku 34-vjeçarja Merita Gremaj ka pretenduar se është dhunuar dhe përdhunuar, ndërsa babai i saj ka mbetur i plagosur.

Përmes një deklarate publike, Caushi ka dhënë versionin e saj lidhur me njohjen mes dajës së saj dhe 34-vjeçares, duke theksuar se ka pasur dijeni vetëm për marrëdhënien mes tyre dhe se për ngjarjen e fundit është informuar nga mediat.

Deputetja ka publikuar edhe një fotografi ku shfaqen Bledar Bakaj dhe Merita Gremaj së bashku, duke sqaruar se i ka takuar rastësisht në fillim të muajit qershor, pranë banesës së dajës së saj.

Sipas Caushit, në atë moment në oborr ndodheshin edhe familjarë e fqinjë dhe Gremaj i ishte prezantuar si bashkëjetuesja e Bakajt.

“E urova padyshim për lidhjen e tyre, pasi atë gjë po bënin edhe fqinjët që ishin prezent dhe më pas, si unë, edhe kushëriri im iu drejtuam: ‘E keni ndarë mendjen? Do martoheni?’”, tregon deputetja.

**Lexo edhe:**

“Daja i Zegjine Caushit më çoi në ferra dhe më përdhunoi”/ Rrëfehet 34-vjeçarja: E kam takuar deputeten

Judis Hoxha, polici i paburrë që goditi me grusht qytetarin e prangosur

Caushi thotë se 34-vjeçarja i kishte pohuar se kishin vendosur të martoheshin, ndërsa kishte përmendur edhe kundërshtimin e të atit për këtë lidhje.

“Merita Gremaj tha: ‘Po po, i kam marrë parasysh kushtet në të cilat Bledari jeton, edhe pse babai s’e ka me qejf…’”, shkruan deputetja.

Ajo shton se më pas e kishte pyetur në mënyrë të drejtpërdrejtë nëse lidhja mund të sillte probleme me familjen e saj, ndërsa situata, sipas saj, ishte kaluar me të qeshura dhe urime

TË GJITHA


“Daja i deputetes më ka përdhunuar”/ Pas akuzës së 34-vjeçares reagon Zegjine Caushi
19:52 : 15/09/2026


Narrativat para vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së
19:47 : 15/09/2026


“Me ç’fytyrë pushtetit i ngjitesh?”/ Protestuesit ironizojnë Ramën me pankarta në ditën e 108-të
19:32 : 15/09/2026


“Arrestoni Ramën”/ Protesuesit marshojnë drejt Kryeministrisë
19:18 : 15/09/2026


Kancelari gjerman njofton masa lehtësuese për çmimet e larta të karburanti
19:13 : 15/09/2026


5 interpelanca urgjente/ Ç’pritet të ndodhë të enjten në Kuvend, zbardhet rendi i ditës
19:05 : 15/09/2026


Sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë?
18:52 : 15/09/2026

nga personat e pranishëm.

Caushi thekson se qëndrimi i saj lidhet vetëm me atë që ka parë dhe dëgjuar personalisht, ndërsa për ngjarjen e raportuar ditët e fundit thotë se është informuar përmes mediave.

“Ky është i gjithë informacioni që kam pasur dhe kam në lidhje me marrëdhënien e tyre. Për këtë ngjarje jam informuar përmes mediave, njësoj si opinioni publik”, shprehet ajo.

Në vijim të deklaratës, deputetja dënon çdo formë dhune, pavarësisht autorit.

“Dua ta them shumë qartë: dënoj me forcë çdo formë DHUNE, pavarësisht se nga KUSH është ushtruar”, shkruan Caushi.

**Etiketa:** daja dhune perdhunim Zegjine Caushi

## Lajme të lidhura



**“Daja i Zegjine Caushit më çoi në ferra dhe më përdhunoi”/ Rrëfehet 34-vjeçarja: E kam takuar deputeten**

13:40 : 15/09/2026



**Judis Hoxha, polici i paburrë që goditi me grusht qytetarin e prangosur**

19:50 : 14/09/2026



**Goditi me grusht në bark qytetarin, Skender Hita pezullon nga detyra efektivin e “Shqiponjave”**

14:39 : 14/09/2026



**VIDEO skandaloze/ Efektivi ‘kamikaz’ i ‘Shqiponjave’ godet me grusht në bark qytetarin e prangosur**

13:03 : 14/09/2026



**DETAJE nga ngjarja në Roskovec/ I ra vjehrrit me çekiç, shpallet në kërkim daja i deputetes Zegjine Çaushi**

09:42 : 14/09/2026



**Rritet dhuna ndaj grave në Elbasan, dyfishohet numri i atyre që kërkojnë urdhër mbrojtjeje**

15:41 : 13/09/2026

RRETH NESH

NA NDIQ




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.